



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 598/12 Prot.

Durrës, më 20. 03. 2024

VENDIM
Nr. 16, datë 20.03 2024

PËR
"NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.39, DATË 29.04.2022 TË SENATIT AKADEMIK
PËR PERSONELIN AKADEMIK TË FTUAR"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 62, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të Administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të UAMD-së neni 47, pika 1, të Rregullores së UAMD-së, neni 105, pika 1, të shkresës nr.528 prot, datë 08.04.2022 "Relacion mbi propozimin e një ndryshimi në Vendimin nr. 39, datë 29.04.2022 të Senatit për personelin akademik të ftuar," Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Për një ndryshim në vendimin nr.39, datë 29.04.2022 të Senatit Akademik për personelin akademik të ftuar, si më poshtë :
 - Njësitë Bazë kanë të drejtë të kërkojnë të punësojnë me kontratë, për periudha të shkurtra kohe, studiues dhe personalitete të fushave të caktura të shkencës dhe të artit, vendas ose të huaj. Për zgjedhjen e personelit akademik të ftuar ndërthuren kualifikimet e tyre me nevojën e njësisë bazë për veprimtari mësimore ose kërkimore – shkencore.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv.Rektorët
 - Dekanët e Fakulteteve
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Juridike

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI





Prof. Dr. Kseanela Sotirofski

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE

Nr. 528 prot

Durrës, më 8.3.2024

Lënda : Relacion mbi propozimin e një ndryshimi në Vendimin nr. 39, datë 29.04.2022 të Senatit për personelin akademik të ftuar.

PROF. DR. KSEANELA SOTIROFSKI
REKTOR

E nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 62, pika 3, Statutit të UAMD-së neni 47, pika 1, Rregullores së UAMD-së neni 105, pika 1, Njësitë Bazë kanë të drejtë të kërkojnë të punësojnë me kontratë, për periudha të shkurtra kohe studiuës dhe personalitete të fushave të caktuara të shkencës dhe të artit, vendas ose të huaj. Për zgjedhjen e personelit akademik të ftuar ndërthuren kualifikimet e tyre me nevojën e njësisë bazë për veprimtari mësimore ose kërkimore-shkencore.

Duke ju falenderuar,

DREJTOR, DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE
Blerina KOKA

Blerina Koka

Konceptoi: B. Kapllani
Nr. Kopjeve: 2(dy)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 558/2 Prot.

Durrës, më 20.3.2024

VENDIM

Nr 22, datë 20.3 2024

PËR

**"MIRATIMIN E PERSONELIT AKADEMIK TË FTUAR PËR VITIN AKADEMIK
2023-2024"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të Administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së, neni 105, të shkresës nr.573/1 prot, datë 19.03.2024, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike, të shkresës nr. 434/2 prot, datë 04.03.2024 të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike, të shkresës nr. 484/1 prot, datë 12.03.2024 të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike, të shkresës nr. 573 prot, datë 18.03.2024 të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike" të shkresës nr. 573/2 datë 19.03.2024 të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike, të shkresës nr.68 prot, datë 11.03.2024, të Departamentit të Shkencave Kompjuterike, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e personelit akademik të ftuar për semestrin e dytë të vitit akademik 2023-2024 si më poshtë :

Departamenti Administrimit Publik:

- Prof.As.Dr. Etleva Leskaj

Departamenti Shkencave Politike:

- Prof.Dr. Qamil Lirëza
- Prof.As.Dr. Çlirim Duro

Departamenti i Drejtësisë:

- Prof.As.Dr. Renata Tokrri
- Dr. Jetmira Fekolli
- Dr. Anila Kazaferi (Dyrma)
- PhD. Emiliano Lule

- Prof.As.Dr. Jonada Bara
- PhD. Siri Hoxha
- Prof.As.Dr. Ersida Teliti

Departamenti Menaxhimit

- Prof.As.Dr. Gaqo Tanko
- Prof.As.Dr. Zamira Sinaj

Departamenti Marketingut

- Prof.As.Dr. Shpëtim Çerri

Departamenti Financë Kontabilitet:

- Prof.Dr. Drini Salko
- Prof.As.Dr. Skënder Uku
- Prof.As.Dr. Elona Fejzaj
- Prof.As.Dr. Albana Gjoni
- Prof.As.Dr. Filloreta Madani

Departamenti Turizmit:

- Prof.Dr. Afrim Hoti
- Prof.As.Dr. Sonila Sinjari

Departamenti Shkencave Kompjuterike:

- Prof.As.Dr. Aleksandër Biberaj
- Prof.As.Dr. Eglantina Xhaja

Departamenti i Gjuhëve të Huaja:

- Prof.Dr. Bardhyl Musai
- Prof.As.Dr. Brunilda Zenelaga

2. Për zbatimit e këtij vendimi ngarkohen:

- Zv.Rektoret,
- Dekanët e Fakulteteve,
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Juridike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE

Nr. 573/prot.

Durrës, më 19.3.2024

Lënda: Mbi miratimin e personelit akademik të ftuar për semestrin e dytë të vitit akademik 2023-2024 Fakulteti Shkencave Politike Juridike.

PROF. DR. KSEANELA SOTIROFSKI
REKTOR

E nderuar,

Në zbatim të nenit 105 të Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, kërkojmë miratimin si personel akademik të ftuar sipas shkresave së përcjella nga Njësitë Kryesore.

Shkresa me Nr. 473/5 prot., datë 13.03.2024, e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike për miratimin e personelit akademik të ftuar për Departamentin e Administrimit Publik:

Departamenti Administrimit Publik

- Prof. As. Dr. Etleva Leskaj

Duke ju falenderuar,

DREJTOR, DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE
Blerina KOKA



*Serati
Shkollë*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE

Nr. 434/prot.
2

Durrës, më 4.3.2024

Lënda: Mbi miratimin e personelit akademik të ftuar për semestrin e dytë të vitit akademik 2023-2024 Fakulteti Shkencave Politike Juridike.

PROF. DR. KSEANELA SOTIROFSKI
REKTOR

E nderuar,

Në zbatim të nenit 105 të Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, kërkojmë miratimin si personel akademik të ftuar sipas shkresave së përcjella nga Njësitë Kryesore.

Shkresa me Nr. 434 prot., datë 28.02.2024, e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike për miratimin e personelit akademik të ftuar për Departamentin e Shkencave Politike:

Departamenti Shkencave Politike

- Prof. Dr. Qamil Lirëza
- Prof. As. Dr. Çlirim Duro

Shkresa me Nr. 434/1 prot., datë 28.02.2024, e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike për miratimin e personelit akademik të ftuar për Departamentin e Drejtësisë:

Departamenti Drejtësisë

- Prof. As. Dr. Renata Tokrri
- Dr. Jetmira Fekolli
- Dr. Anila Kazaferi (Dyrma)
- PhD. Emiliano Lule
- Prof. As. Dr. Jonad Bara
- PhD. Siri Hoxha
- Prof. As. Dr. Ersida Teliti

Duke ju falenderuar,

DREJTOR, DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE
Blerina KOKA

Konc.: P. S. B. Nj. B. Kapllani
Nr. i Kopjeve: 3 (tre)

- Prof.As.Dr. Renata Tokrri prej vitit 2016 është angazhuar si lektore me kohë të plotë pranë Departamentit të Drejtësisë, në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, si dhe ka mbajtur pozicionin e Zëvendës Rektores së UAMD-së. Prof.As.Tokrri ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, si diplomë e dyfishtë midis Departamentit të Drejtësisë dhe departamenteve respektive të Universitetit "Tor Vergata" të Romës, Itali apo / edhe Universitetit "Sapienza" të Romës, Itali. Znj.Tokrri ka përfunduar Studimet Doktorale në vitin 2015 pranë Departamentit të së Drejtës Publike në Universitetin "Tor Vergata" në Romë. Në vitin 2010 ka përfunduar studimet e larta Master i Shkencave të Integruar në Drejtësi në Universitetin "La Sapienza" në Romë. Gjithashtu ajo zotëron dy Diploma Post Master, në "Kriminologji dhe Kriminalistikë" dhe në "Jurist Ndërkombëtar", të mbrojtura në Universitetin Castel Sant'Angelo, në Romë. Aktiviteti i saj kërkimor është përqendruar në fushën e së drejtës kushtetuese. Ajo është autore dhe bashkë-autore e disa publikimeve në revista shkencore, konferenca rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Dr. Jetmira Fekolli nga janari i vitit 2018 ka fituar gradën shkecore "Doktor i Shkencave" në Filozofi, ka përfunduar studimet e ciklit të parë në Filozofi si "Student i Shkëlqyer" në vitet 2005-2008 në Universitetin e Tiranës. Në vitet 2008-2010 ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në "Filozofi Sociale" po në Universitetin e Tiranës. Nga viti 2012 e në vazhdim jam lektore e disa lëndëve universitare si Filozofi e përgjithshme, Filozofi gjuhe, Filozofi Komunikimi, Teori Institucionale, Morali dhe Politika, Natyra dhe Historia, Filozofi e Fese, Metodologji e Kërkimit Shkencor. Aktualisht pedagoge me kohë të plotë pranë njësisë bazë të Filozofisë në Universitetin e Tiranës që prej 9 dhjetor 2020 e në vazhdim. Interesat kryesore të kërkimit janë: Gjuha, komunikimi, kërkimi shkencor, morali, politika, historia, feja, shojegimi filozofik, epistemologjia etj. Ajo është autore dhe bashkëautore e disa artikujve botuar brenda dhe jashtë vendit, autor i moduleve të edukimit në fushën e arsimit, pjesëmarrëse në projekte kërkimore, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Dr. Anila Kazaferi, është Eksperte e psikiatrisë ligjore pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore, Konsulente Psikiatre pranë Shërbimit të Psikiatrisë pranë Qendrës Studimore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë dhe gjithashtu, Psikiatre pranë Shërbimit të Psikiatrisë QSUT. Dr. Anila Kazaferi mban gradën shkecore të Doktoraturën për "Vlerësimin fenomenologjik të prediktorëve dhe faktorëve të riskut, përfshirë depresionin miqs, në ciklimin e shpejt të çrregullimit bipolar" dhe Master i Shkencave me mikrotezën "Vlerësim i efektit të Lamotriginës kundrejt Karbonatit të Litiumit në pacientët me çrregullim bipolar II". Dr.Kazaferi është vlerësuar me çmimin Poster Aëard 'Prospective Study of PTSD's impact in rapid cycling bipolar disorder' 3rd International Congress on Neurobiology, Psychopharmacology & Treatment Guidance, Selanik, Greqi. Znj.Kazaferi është pjesëmarrëse në shumë konferenca shkencore dhe kongrese kombëtare dhe

ndërkombëtare, trajnime të OBSH-së, si dhe shoqata shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si: Shoqata Shqiptare e Psikiatrisë, Lidhja e Psikiatrisë Shqiptare dhe Shoqata Europiane e Psikiatrisë.

- **PhD.Emiliano Lule** është drejtor pranë Institutit të Nxënësve që Nuk Shikojnë. Z.Lule ka PhD nga Institute of Education, Universiteti i Londrës në mikrotezën:

“Një studim i teknologjisë asistive në edukim, që lehtëson të nxënët tek individët me vështirësi në të nxënët”, “Përfshirja sociale dhe politika të përshtatshmërisë të aplikuara në edukimin special tendencat aktuale për zhvillim të përshtatshmërisë në sistemin e edukimit”, “Përvojat e nxënësve me aftësi ndryshe gjatë përdorimit të sistemeve E-learning dhe barrierat gjuhësore”, “Ndërfaqet e E-learning, aksesueshmëria dhe aspekte të tjera të aksesit në informacion” dhe “Nivelet e funksionimit dhe teknika të reja të zhvillimit të teknologjisë asistive brenda edukimit special”. Z.Lule ka Master Shkencor në ‘Gazetari dhe Shkenca të Komunikimit’ si dhe në ‘Psikologji Klinike, Zhvillim dhe Marrëdhëniesh’, i vlerësuar me Medalje të Artë.

- **Prof.Asoc.Dr. Jonad Bara**, prej viti 2019 është Lektor pranë Departamentit të së Drejtës Penale, të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Aktualisht është Zëvendësdekan i këtij fakulteti.

Prof.As.Bar ka mbaruar studimet universitare në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 2000 dhe studime pasuniversitare në Girton College, Cambridge të Mbretërisë së Bashkuar. Përfunduar studimet doktorale në vitin 2013. Fituar titullin shkencor “Profesor i Asociuar” në vitin 2023. Pjesëmarrës në konferenca të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit me fokus të veçantë të drejtës penale kombëtare dhe atë ndërkombëtare; në aktivitete, trajnime, ëorkshope, etj. Z.Bar ka një eksperiencë shumëvjeçare në fushën e së drejtës penale ndërkombëtare dhe marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në çështje penale. Ai është përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme në veprimtari dhe projekte të shumta si: në Grupin Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”; në procedurat për negociimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes për Bashkëpunimin e Republikës së Shqipërisë me EUROJUST; në negociatat me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për përditësimin e Marrëveshjes Bilaterale të Ekstradimit me shtetin Shqiptar; në hartimin e marrëveshjes me Britaninë e Madhe dhe Irlandën e Veriut për transferimin e personave të dënuar; në takimet e Komitetit Drejtues të programit Rajonal IPA 2014 “Bashkëpunimi Ndërkombëtar në Drejtësinë Penale: Rrjeti i Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor”; ILECU I dhe II, IPA, DET-ILEKU II, UNCAC; në tryeza të përbashkëta me përfaqësues të autoriteteve të shteteve të huaja si: Italisë, Austrisë, Hollandës, Mbretërisë së Bashkuar, Rumanisë, etj. për zhvillimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në çështje penale, si dhe në diskutime për çështje konkrete, etj. Pjesëmarrës në projekte të ndryshme Erasmus+ të Komisionit Evropian për studentët e arsimit të lartë (javët e mësimdhënies për stafin), me fokus të veçantë në forcimin e bashkëpunimit mes Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës dhe universiteteve të tjera evropiane, si dhe në metodologjitë dhe përqasjet e reja për kërkimin shkencor dhe mësimdhënien e drejtësisë juridike/ligjore. Autor libri si dhe i një sërë artikujsh shkencorë në fushën e të drejtës kushtetuese, penale, procedurale

penale dhe shëndetësore, në revista shkencore të njohura brenda dhe jashtë vendit, të indeksuara nga Scopus e Thomson Reuters.

- **PhD.Siri Hoxha** ka përfunduar studimet e larta për Histori në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Histori - Filologjisë në vitin 1995. Për rezultate të shkëlqyera është emëruar pas përfundimit të studimeve, si punonjës shkencor kërkimor në Institutin e Historisë të Akademisë së Shkencave. Nga viti 2000 - 2010 ka qënë drejtues i disa institucioneve të arsimit të mesëm, hartues kurrikulash të arsimit të lartë, si dhe gazetar dhe drejtues i disa mediave përfshirë 'Vizion +' e 'Mediasat'. Ka përfunduar ndërkohë edhe studimet e plota (bachelor + master) në shkenca juridike. Nga viti 2010 e deri në 2023 është përfshirë në mësimdhënie pranë Kolegjit Universitar Pavarësia Vlorë duke qënë gjatë gjithë kohës edhe drejtues i këtij institucioni në pozicionet: Shef Departamenti, Zv/Rektor dhe Rektor. Mban gradën shkencore 'Doktor'. Në vitin 2019 ka marrë nga Univeriteti 'San Cyrili' i Maltës titullin "Doktor i Shkencave në Shkenca Ekonomike".

- **Prof.Asoc.Dr.Erside Teliti** është lektore pranë Departamentit të së Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës që prej vitit 2008. Në vitin 2006, Prof. asoc. Teliti është diplomuar pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, me medalje të artë. Në vitet 2006-2008 ajo ka qënë pjesë e personelit akademik të Universitetit të Durrësit. Fushat e saj të kërkimit janë fokusuar kryesisht në të drejtën e detyrimeve dhe të kontratave, të drejtën e transportit, si dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Prof. Asoc. Teliti është Drejtore Ekzekutive e Qendrës "Konsumatori shqiptar". Ajo ka zhvilluar një sërë aktivitete me fokus mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve shqiptarë. Është eksperte në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, në studime të organizuara nga institute kombëtare dhe ndërkombëtare. Zotëron licencën e avokates, ndërmjetëses dhe auditueses së brendshme.

Prof. Dr. Qamil Lirëza - ekspert i çështjeve që i përkasin Gjeografisë Ekonomike. Ka një karrierë të dalluar akademike në këtë fushë. Autor i disa botimeve bashkëkohore. I cituar nga shumë studiues. Programi lëndës "Gjeografi Ekonomike" që ka prezantuar nga Prof. Lirëza është gjetur mjaft me vlerë nga anëtarët e Departamentit Administrim Publik për studentët e profilit Politikë Ekonomike, duke realizuar në këtë mënyrë gërshtimin e nocioneve të kësaj lënde me gjeopolitikën. Aktualisht i angazhuar si lektor me kohë të plotë pranë Universitetit të Elbasanit. Ftohet të lektrojë lëndët "Gjeografi Urbane".

Prof. Asoc. Dr. Çlirim Duro është i punësuar si personel akademik me kohë të plotë, pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

Ka një përvojë pune prej rreth 23 vjetësh si personel akademik dhe si specialist në sigurimin e cilësisë dhe në akreditimin e arsimit të lartë, në Shqipëri. Pas diplomimit në Histori, në vitin 1997, studimet e thelluara pasuniversitare (SHPU) i kreu në vitin 2004, ato doktorale në vitin 2013 dhe në 2016 dhe titullin akademik prof.asoc.dr.. Objekt të studimit në SHPU dhe në Shkollën e Doktoratës, ka qenë historia e arsimit të lartë në periudhën komuniste. Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë, periudhën komuniste në vitet 1944-1990 dhe zhvillimet arsimore në shekullin e XX-të.

Ka marrë pjesë në disa projekte kombëtare/ndërkombëtare si: Koordinator kombëtar i Projektit Tempus *"Enhancing albanian system of quality assurance in higher education: application of the process- and outcome-based methodology"* 2013-2016"; Kordinator i projektit *"Clean Score Project Research & Development Unit/ Cilësia e materialeve mësimore dhe vlerësimi i performancës së studenteve"*, me Fondin Shqiptar Amerikan të Zhvillimit»; Implementues i projektit *"Vlerësimi i potencialeve dhe propozim i zhvillimeve në zonën e basenit të lumit Drin"*, ndërtimi i Muzeut të Kaskadës së Drinit; etj.

Ka shërbyer në pozicione drejtuese:


- Drejtor i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë në UT.
- Kryetar i Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) në UET
- Përgjegjës i sektorit të promocionit dhe sigurimit të cilësisë, Agjencia
- Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë
- Përgjegjës i sektorit të publikimeve dhe informacionit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë

Ka botuar një monografi shkencore me titull: *"Arsimi i Lartë në Shqipëri 1945-1968"*, Korrik 2015; "Uet Press", ISBN 978-9928-190-42-0 dhe një sërë artikujsh të ndryshëm shkencorë në revista brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Aktualisht Drejtor i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë në Univesitetin e Tiranës dhe personel akademik me kohë të plotë në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë UT.



*Seashit
Kadriu*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE

Nr. 484/prot.

Durrës, më . . . 2024

Lënda: Mbi miratimin e personelit akademik të ftuar për semestrin e dytë të vitit akademik 2023-2024 Fakulteti Biznesit.

PROF. DR. KSEANELA SOTIROFSKI
REKTOR

E nderuar,

Në zbatim të nenit 105 të Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, kërkojmë miratimin si personel akademik të ftuar sipas shkresave së përcjella nga Njësitë Kryesore.

Shkresa me Nr. 484 prot., datë 05.03.2024, e Dekanit të Fakultetit të Biznesit për miratimin e personelit akademik të ftuar për për semestrin e dytë të vitit akademik 2023-2024, Fakulteti Biznesit:

Departamenti Menaxhimit

- Prof. As. Dr. Gaqo Tanku
- Prof. As. Dr. Zamira Sinaj

Departamenti Marketingut

- Prof. As. Dr. Shpëtim Çerri

Departamenti Financë Kontabilitetit

- Prof. Dr. Drini Salko
- Prof. As. Dr. Skënder Uku
- Prof. As. Dr. Elona Fejzaj
- Prof. As. Dr. Albana Gjoni
- Prof. As. Dr. Filloreta Madani

Departamenti Turizmit

- Prof. Dr. Afrim Hoti
- Prof. As. Dr. Sonila Sinjari

Duke ju falenderuar,

DREJTOR, DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE
Blerina KOKA

Konc.: P. S. B. Nj. B. Kapllani
Nr. i Kopjeve: 3 (tre)

[Signature]



Sotir
Kesanel



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE

Nr. 573 prot.

Durrës, më 18.3 .2024

Lënda: Mbi miratimin e personelit akademik të ftuar për semestrin e dytë të vitit akademik 2023-2024 Fakulteti Teknologjisë së Informacionit.

PROF. DR. KSEANELA SOTIROFSKI
REKTOR

E nderuar,

Në zbatim të nenit 105 të Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, kërkojmë miratimin si personel akademik të ftuar sipas shkresës së përcjellë nga Njësia Kryesore.

Shkresa me Nr. 473/4 prot., datë 12.03.2024, e Dekanit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit për miratimin e personelit akademik të ftuar për Departamentin e Shkencave Kompjuterike:

Departamenti Shkencave Kompjuterike

- Prof. As. Dr. Aleksandër Biberaj
- Prof. As. Dr. Eglantina Xhaja

Duke ju falenderuar,

DREJTOR, DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE
Blerina KOKA

Blerina Koka

Konc.: P. S. B. Nj. B. Kapllani
Nr. i Kopjeve: 3 (tre)

3/4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Nr. 68 prot

Durrës, më 11.03.2024

RELACION

Lënda: Kerkese per angazhim si lektor te ftuar, i stafit akademik PT ne departamentin Shkenca Kompjuterike ne ciklin e dyte te studimeve master, per semestrin II, vitin akademik 23-24.

PËR: Prof. As. Dr. Lindita MUKLI
Dekan Fakulteti Teknologji Informacioni

Në zbatim të rregullores së UAMD, Neni 105, "Personeli Akademik i ftuar", më poshtë gjeni një relacion në lidhje me angazhimin e stafit të ftuar në departamentit Shkenca Kompjuterike, për semestrin e dytë, viti akademik 2021-2022:

1. Prof. As. Dr. Eglantina Kalluci / Kursi: Inxhinieri Avancuar SW, 2 seksione (Master)
2. Prof. AS. Dr. Aleksander Biberaj / Kursi: Siguri Informacioni, 1 seksion (Master)

DSHK, kerkon te ftoje ne procesin e mesimdhenies, Profesoret e Asociuar, E. Kalluci dhe A. Biberaj, si nje vlere e shtuar ne departamentin tone. Profesoret kane nje eksperience disa vjecare ne mesimdhenie ne fushen ku ata po angazhohen, kehstuqe mund te japin kontributin shkencor dhe profesional.

Gjithashtu, profesoret plotesojne nevojat e DSHK, per staf akademik te kualifikuar me tituj dhe grada, duke respektuar edhe kerkesat e Ligjit mbi Arsimin e Larte.

Duke ju falenderuar per mirekuptimin

Dr. Senada BUSHATI
Përgjegjës Departamenti Shkenca Kompjuterike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE

Nr. 573 / prot.

Durrës, më 19. 3. 2024

Lënda: Mbi miratimin e personelit akademik të ftuar për semestrin e dytë të vitit akademik 2023-2024 Fakulteti Edukimit.

PROF. DR. KSEANELA SOTIROFSKI
REKTOR

E nderuar,

Në zbatim të nenit 105 të Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, kërkojmë miratimin si personel akademik të ftuar sipas shkresës së përcjellë nga Njësia Kryesore.

Shkresa me Nr. 484/2 prot., datë 12.03.2024, e Dekanit të Fakultetit të Edukimit për miratimin e personelit akademik të ftuar për Departamentin e Gjuhëve të Huaja:

Departamenti Gjuhëve të Huaja

- Prof. Dr. Bardhyl Musai
- Prof. As. Dr. Brunilda Zenelaga

Duke ju falenderuar,

DREJTOR, DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE
Blerina KOKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
FAKULTETI I EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Nr. 442 prot.

Durrës, më 06/03/2024

Lënda: "Propozim për lektorë të ftuar për semestrin e dytë, viti akademik 2023-2024"

DEKANIT
Pro. As. Dr. KLODIANA LEKA

E nderuar znj. dekan,

Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Edukimit, UAMD, kërkon të angazhojë si lektorë të ftuar për semestrin e dytë, viti akademik 2023-2024, në ciklin e dytë të studimeve si mëposhtë vijon:

1. Prof. Dr. Bardhyl Musai
2. Prof. As. Dr. Brunilda Zenelaga

Kërkesa e Departamentit të Gjuhëve të Huaja mbështetet në kualifikimet shkencore, veprimtarinë kërkimore dhe mësimdhënëse të Profesorëve të sipërpërmendur. Ata janë autorë të disa botimeve universitare dhe kanë një përvojë shumëvjeçare në mësimdhënie në institucione të ndryshme të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Prof. Dr. Bardhyl Musai është titullar i disa lëndëve në Universitetin e Tiranës si "Metodologji e Mësimdhënies", "Të menduarit kritik", etj. dhe ka realizuar një sërë botimesh shkencore në këto fusha. Është për t'u theksuar gjithashtu pjesëmarrja e tij në një sërë aktiviteteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Prof. As. Dr. Brunilda Zenelaga është titullare e disa lëndëve në Universitetin e Tiranës si "Etikë dhe komunikim", "Metoda të kërkimit shkencor", etj. dhe ka realizuar një sërë botimesh shkencore në këto fusha. Është për t'u theksuar gjithashtu pjesëmarrja e saj në një sërë aktiviteteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Duke marrë parasysh të gjithë elementet e mësipërm, Departamenti i Gjuhëve të Huaja e konsideron të përshtatshëm angazhimin e Prof. Dr. Bardhyl Musai dhe Prof. As. Dr. Brunilda Zenelaga si lektorë të ftuar për semestrin e dytë, në ciklin e dytë të studimeve, viti akademik 2023-2024.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

DREJTUESI I NJËSISË BAZË

Prof. As. Dr. Anita Muho